



UNMIK



IPVK

**INSTITUCIONET E PËRKOSSHME TË VETQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT**

**QEVERIA E KOSOVËS/ MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
VLADA KOSOVA/ MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL
DEVELOPMENT**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV MA. NR. 06 /2005
PËR REGJISTRIMIN, LICENCIMIN E PRODHUSËVE TË
MATERIALIT FIDANOR PYJOR DHE FIDANEVE
TË BIMËVE DEKORATIVE DRUNORE**

**Mars 2005
PRISHTINË**



UNMIK



IPVK

**INSTITUCIONET E PËRKOSHME TË VETQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT**

**QEVERIA E KOSOVËS/ MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
VLADA KOSOVA/ MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL
DEVELOPMENT**

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural , duke u bazuar në:

Rregulloren e UNMIK-ut nr.2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degen e Ekzekutivit të Institutacioneve të Përkoshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 1.3 pika (d) Ligjit për Pyjet e Kosovës Nr.2003/3 të datës 20 mars 2003 neni 31; dhe Ligjit për Materialin Fidanor Nr.2004/16 të datës 28 maj 2004, neni 3,10, dhe 24,

Nxjerr sa vijon:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV MA. NR. 06 /2005
Për regjistrimin, licencimin e prodhuesve të materialit fidanor pyjor dhe fidaneve
të bimëve dekorative drunore**

Neni 1

Ky Udhëzim Administrativ përcakton kushtet për regjistrimin dhe caktimin e taksës për licencimin e prodhuesve të materialit fidanor pyjor dhe bimëve dekorative drunore.

Neni 2

Askush nuk mund të prodhojë, paketoj, etiketoj apo të vendë në treg material fidanor pyjor, dhe bimëve dekorative drunore nëse nuk është i regjistruar dhe licencuar sipas këti Udhëzimi Administrativ.

Neni 3

1. Personat të cilët mirren me prodhimin e materialit fidanor pyjorë dhe bimëve dekorative drunore duhet të licencohen nga Autoriteti Licencues – Departamenti i Pylltarisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Personi juridik ose fizik për tu licencuar si prodhues i materialit fidanor dhe bimëve dekorative drunore duhet ti plotësojë kushtet e veçanta siç janë:

- a) të plotësojë kërkesen mbi veprimtarin përkatëse,
- b) të siguroi dëshmi për angazhim të ekspertit të lëmisë së pylltarisë apo ndonjë lëmi tjetër përkatëse,
- c) të ketë çertifikaten e regjistrimit të biznesit dhe informatën mbi biznesin,
- d) të posedoj planin e fidanishteës amë,
- e) të siguroi dëshmi për origjinën valide të materialit amë i përdorur për prodhimin e materialit fidanor pyjorë(materiali riprodhues) dhe kategoritë e materialit fidanor pyjorë,
- f) të siguroj dëshmi për llojin/et dhe kategorinë/të e materialit fidanor pyjorë që synon të prodhojë,
- g) të siguroj testin e analizave paraprake të tokës dhe humusit,
- h) të siguroj të dhënat mbi largësinë mbi detare, ekspozicionin, dhe të dhënat tjera mikro – klimatike,
- i) dëshmin mbi pagesën e taksës në shumën prej 20€.

Neni 4

1. Autoriteti Licencues --- Departamenti i Pylltarisë ia lëshon licencën aplikuesit në formë të shkruar, pas dëshmisë mbi pagesën e taksës në shumën prej 20 € dhe plotësimit të kushteve konform nenit 4 të këtij Udhëzimi Administrativ.
2. Nëse dokumentacioni nuk është i kompletuar, palës i ipet afati mbrenda 10 ditësh për kompletimin e dokumentacionit.
3. Nëse aplikuesi nuk arrinë që ta bëjë kompletimin e dokumentacionit në afatin shtesë kërkesa refuzohet.

Neni 5

Para se Autoriteti Licencues – Departamenti i Pylltarisë të vendos për dhënjen e licences duhet të marrë raportin aprovues nga Inspektori Pyjorë, për plotësimin praktik të kushteve sipas kërkesës për aplikim.

Neni 6

1. Autoriteti Licencues është i obliguar ta lëshoi licencën mbrenda 30 ditësh nga dita e aplikimit respektivisht kompletimit të dokumentacionit.
2. Nëse personi i licencuar për prodhimin e materialit fidanor pyjor vepron në kundërshtim me licencë, dhe kriteret e përcaktura me këtë Udhëzim Administrativ, Autoriteti Licencues mund të pezullojë apo anulojë licencën.

Neni 7

Kohëzgjatja e licences është 5 vite me mundësi të ripërrirjes. Përrirja e licences për prodhimin e materialit fidanor pyjor dhe bimëve zbukuruse drunore bëhet pas pagesës së taksës administrative në vlerën prej 15€.

Neni 8

Personat që mirren me prodhimin e materialit fidanor pyjor janë të obliguar të mbajnë shenime për origjinën e materialit amë, përdorimin e pesticideve dhe medikamenteve për mbrojtjen e materialit fidanor nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

Neni 9

Personat që veprojnë në kundërshtim me këtë Udhëzim Administrativ do të ndëshkohen sipas nenit 36 të Ligjit për Pyjet, dhe nenit 21 të Ligjit për Materialin Fidanor.

Neni 10

Autoriteti Licencues do të informoj prodhuesit për llojin e fidaneve pyjore dhe bimëve dekorative pyjore të ndaluara për prodhim.

Neni 11

Sipas kërkesave të DP – së prodhuesit e materialit fidanor pyjor janë të obliguar që së paku një herë në vitë të njoftojn DP – së, për sasin, llojin, varietetin, moshën, gjendjen shëndetësore të materialit fidanor të prodhuar .

Neni 12

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 23.03. 2005

ZvMinistri i Ministrisë së Bujqësisë,
Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural

/ Tomë Hajdaraj/